

UDHËZUES
PËR MONITORIMIN E DOKUMENTEVE
STRATEGJIKE,
SIMJET PËR MATJEN DHE VLERËSIMIN E
PROCESEVE INTEGRUESE



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PUBLIKUES

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)
Rr. Milto Tutulani, Nd.1, Ap. 3. (Dora D'Istria)
Tel: +355 44 104 247
E-mail: info@em-al.org
Web: www.em-al.org

AUTOR/E

Bojana HAJDINI

VITI I PUBLIKIMIT:

2025

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga
Bashkimi Evropian



HYRJE	03
<hr/>	
KUPTIMI DHE RËNDËSIA E DOKUMENTEVE STRATEGJIKE	04
<ul style="list-style-type: none"> • Çfarë janë dhe pse shërbejnë dokumentet strategjike 04 • Pse është i rëndësishëm procesi i monitorimit të dokumenteve strategjike në kuadër të proceseve integruese 05 	
<hr/>	
STRUKTURA E DOKUMENTEVE STRATEGJIKE DHE ELEMENTET PËRBËRËSE TË TYRE	06
<hr/>	
KUPTIMI DHE PËRMBAJTJA E ELEMENTEVE TË STRUKTURËS PËRBËRËSE TË NJË DOKUMENTI STRATEGJIK	07
<ul style="list-style-type: none"> • Kuptimi dhe përmbajtja e “Pjesës I: Konteksti strategjik” 07 • Kuptimi dhe përmbajtja e “Pjesës II – Qëllimi i politikave dhe objektivat specifike të strategjisë” 12 • Kuptimi dhe përmbajtja e “Pjesës III – Projektet/programet kombëtare të zhvillimit për zbatimin e strategjisë” 21 • Kuptimi dhe përmbajtja e “Pjesës IV - Përgjegjësia e institucioneve, llogaridhënia, koordinimi, monitorimi dhe vlerësimi” 21 • Kuptimi dhe përmbajtja e “Pjesës V – Analiza e buxhetit” 23 • Kuptimi dhe përmbajtja e “Planit të Veprimit” 24 • Kuptimi dhe përmbajtja e “Pasaportës së treguesve” 26 	
<hr/>	
MONITORIMI I ZBATIMIT TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKË	32
<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i brendshëm 32 • Monitorimi i jashtëm 32 	
<hr/>	

HYRJE

Udhëzuesi për Monitorimin e Dokumenteve Strategjike ka për qëllim që të sqarojë lexuesin për rëndësinë e dokumenteve strategjike, strukturën dhe përmbajtjen e tyre, si edhe mënyrën se si ato duhet të hartohen dhe të kuptohen nga publiku i gjerë. Udhëzuesi, shërben si një metodologji pune, e cila mund të orientojë shoqërinë civile, akademikët apo qytetarët në vlerësimin e dokumenteve strategjike si në fazën e hartimit kur ato paraqiten për konsultim, ashtu edhe në monitorimin e shkallës së zbatimit të tyre.

Në këtë kontekst udhëzuesi shpjegojen në mënyrë të detajuar të gjithë elementët që nga pikëpamja strukturore që duhet të ketë një strategji. Për secilin element, jepet kuptimi dhe përmbajtja, me qëllim dhënien e mundësisë, lexuesit apo monitoruesit për të vlerësuar saktësinë e hartimit. Për këtë çdo element përbërës i një strategjie, shoqërohet me një listë pyetjesh kontrolli që do i shërbejë atyre në vlerësimin e çdo pjese në përberje të dokumentit.

Gjithashtu, parë rëndësinë e madhe që ka monitorimi i dokumenteve strategjike për të kuptuar progresin e vizionit të sektorit, i cili pasqyron njëkohësisht qasjen ndaj progresit në proceset integruese, në këtë dokument, jepen udhëzime, me qëllim monitorimin e tyre. Në këtë kuadër, Udhëzuesi tregon hapat konkretë që duhet të ndiqen për organizimin e punës, apo mënyrën si mund të përdoren të dhënat e pasaportës së treguesve për matjenerezultateve të pritshme, nëpërmjet vlerave të synuara.

Për të ardhur në ndihmë dhe për të kuptuar sa më sipër, për ilustrim janë marrë shembuj konkretë nga Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024-2030.

KUPTIMI DHE RËNDËSIA E DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

ÇFARË JANË DHE PSE SHËRBEJNË DOKUMENTET STRATEGJIKE

Dokumentet strategjike janë plane të detajuara që ndihmojnë organizatat të përcaktojnë dhe të realizojnë qëllimet e tyre afatgjata, duke siguruar që të gjitha aktivitetet të jenë të koordinuara dhe të orientuara drejt suksesit të qëndrueshëm¹.

Dokumentet strategjike janë të rëndësishëm për çdo sektor që mbulojnë, si dhe institucionin përgjegjës të tij, pasi ata shërbejnë si udhërrëfyes për arritjen e qëllimeve dhe objektivave afatgjata të sektorit, në një afat kohor zakonisht 5-vjeçar. Sa i takon sektorit apo fushës që mbulojnë dokumentet strategjike ndahen në sektoriale dhe ndërsektorale.

Planifikimi strategjik dhe hartimi i dokumenteve respektive sjell një sërë përfitimesh. Ndër to mund të përmendim:

- Së pari, dokumentet strategjike përcaktojnë një vizion të qartë për sektorin, duke vendosur për qëllimet dhe objektivat afatgjata, të cilat në çdo rast duhet të përputhen me qëllimet e politikave kryesore në vend, si dhe me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.
- Së dyti, duke identifikuar vizionin e fushës apo sektorit, institucionet kanë mundësi të prioritojnë masat apo veprimtaritë që duhen të ndërmerren për të arritur këto qëllime, si dhe ato mundësojnë që ato të jenë në përputhje me objektivat afatgjata.
- Së treti, planifikimi strategjik është një proces që ndihmon në menaxhimin efektiv dhe eficient të burimeve njerëzore dhe financiare. Duke përcaktuar se cilat masa janë më të rëndësishme dhe më primare për arritjen e objektivave, ato ndihmojnë në orientimin e duhur të burimeve.
- Së katërti, planifikimi strategjik, bën të mundur një monitorim të matshëm, ku bazuar në të dhëna, vlerësohet shkalla e realizimit të objektivave, duke orientuar institucionet në bërjen e ndryshimeve kur është e nevojshme.
- Së fundi, gjithë procesi i planifikimit, hartimit dhe monitorimit të dokumenteve strategjike rrit besimin e publikut tek institucionet qeverisëse, duke qenë se krijon imazhin e institucioni të angazhuar në sektor, rrit transparencën dhe forcon llogaridhënien.

[1] Strategy Document: A Comprehensive Guide for Businesses <https://stratagora.com/str>

PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM PROCESI I MONITORIMIT TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE NË KUADËR TË PROCESIVEVE INTEGRUESE

Dokumentet strategjike janë dokumente të gjallë, zbatimi i të cilave duhet të monitorohet, për të matur progresin, apo për t'iu përshtatur nevojave të reja që mund të dalin gjatë zbatimit. Për vende që aspirojnë integrimin në Bashkimin Europian, procesi i hartimit dhe monitorimit bëhet edhe më i rëndësishëm.

Kjo pasi:

- Së pari, në kuadër të detyrimeve që u burojnë nga procesi i anëtarësimit në BE, shtetet candidate duhet të arrijnë objektiva të përbashkëta në fusha si: tregtia, qeverisja, shteti i së drejtës, mbrojtja e të drejtave të njeriut, siguria dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Hartimi i strategjive, bën të mundur që detyrimet e proceseve të integritit të vihen në jetë, duke u përkthyer në politika apo objektiva sipas sektorëve të caktuar. Ndërkohë, monitorimi i dokumenteve strategjike siguron që aktivitetet dhe masat e marra të ecin drejt realizimit të qëllimeve afatgjata të Bashkimit Europian, të përkthyer në politika dhe objektiva strategjike.
 - Së dyti, monitorimi ofron të dhëna të qarta të cilat matin progresin e masave të ndërmarra, në kuadër të detyrimeve që burojnë nga BE, duke dhënë një panoramë të qartë për progresin e bërë dhe sfidat që duhet të trajtohen dhe zgjidhen. Në këtë mënyrë, referuar raporteve të monitorimit, vlerësohet nëse vendet janë në rrugën e duhur për të përmbushur kriteret që burojnë në kuadër të procesit të integritit europian.
 - Së treti, monitorimi ndihmon në rritjen e llogaridhënies dhe transparencës, duke lejuar që palët e interesuara, qytetarët dhe vetë institucionet e BE të jenë të informuar për arritjet dhe kërkesat e mëtejshme në proceset e integritit.
 - Së katërti, monitorimi rrit shkallën e zbatueshmërisë dhe të suksesit të reformave integruese. Kur një plan strategjik monitorohet në mënyrë të rregullt, institucionet rrisin shkallën e përgjegjshmërisë duke bërë të mundur ndërmarrjen në kohë të veprimeve dhe masave, duke shmangur vonesat të cilat mund të dëmtojnë si arritjet në sektor, ashtu edhe procesin reformues në kuadër të integritit europian.
 - Në përfundim, monitorimi i dokumenteve strategjike është thelbësor për të siguruar që procesi e integritit europian të jenë të suksesshme, të qëndrueshme, duke i mundur vendeve candidate dhe Bashkimin Europian arritjen e qëllimit për një integrim të shpejtë dhe të suksesshëm.
-

STRUKTURA E DOKUMENTEVE STRATEGJIKE DHE ELEMENTET PËRBËRËSE TË TYRE

Të gjitha dokumentet strategjike ndjekin një strukturë, ku elementet përmbajtësore, të ndara në pjesë dhe nënndarje të çdo pjesë, kanë një renditje kronologjike të caktuar. Dokumentet strategjike sektoriale apo ndërsektoriale të hartuara nga institucionet shqiptare, ndjekin një strukturë template, të përcaktuar në dokumente udhëzuese, të hartuara nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC)².

Dokumentet strategjike strukturohen në 5 pjesë kryesore:

- **Pjesa e parë:** Konteksti strategjik - Këtu caktohet pjesa hyrëse e strategjisë, e cila përmban qëllimin e dokumentit strategjik, një analizë së kuadrit ligjor dhe institucional që përcakton gjendjen e sektorit në momentin e hartimit të strategjisë, arritjet dhe sfidat e sektorit, duke përcaktuar si konkluzion të analizës vizionin dhe misionin lidhur me sektorin strategjik.
- **Pjesa e dytë:** Qëllimi i politikave dhe objektivat specifike të strategjisë - Kjo përbën pjesën kryesore të dokumentit strategjik, ku vizioni i sektorit strategjik zërthehet dhe jetësohet në qëllime politikash strategjike, objektiva specifike, rezultate të pritshme, masa që duhen të ndërmerren për arritjen e tyre, si dhe përcaktohen tregues për matjen e progresit.
- **Pjesa e tretë:** Projektet/Programet kombëtare të zhvillimit për zbatimin e strategjisë - Kjo pjesë bën lidhjen e qëllimeve të politikave të strategjisë me projektet ose programet kombëtare, që mund të kontribuojnë në realizimin e një apo disa politikave. Kjo pjesë plotësohet nëse nëse një gjë e tillë është e aplikueshme për sektorin dhe dokumentin strategjik, pasi jo çdo dokument detyrimisht ka një kre të tillë.
- **Pjesa e katërt:** Zbatimi, përgjegjësia e institucioneve, llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi - Në këtë pjesë jepen institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave, mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, si dhe atyre për përpunimin e tyre dhe hartimin e raporteve të monitorimit. Kjo ndihmon që të detajohen proceset e monitorimit, vlerësimit dhe mundësitë për përmirësime në funksion të efektivitetit.
- **Pjesa e pestë:** Analiza buxhetore - Kjo pjesë përcakton në mënyrë të detajuar efektet financiare të zbatimit të strategjisë, duke përcaktuar për çdo masë, objektivi e qëllim politike kostot kapitale dhe korrente si dhe burimin e financimit, për çdo vit të zbatimit të strategjisë.

[2] Sqarimi i elementeve përbërëse në strukturën e një strategjie, do t'i referohet shpjegimeve dhe strukturës së modelit standard, të miratuar nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC), për dokumentet strategjike, i cili është sqaruar në dy dokumentet "Kuadri strukturor për hartimin e strategjive sektoriale/strategji ndërsektoriale në përputhje me standardet e sistemit IPSIS", si dhe "Format "strategjia sektoriale / ndërsektoriale kombëtare". Për referencë janë përdorur edhe dokumentet strategjike në fuqi. Ilustrimi me shembuj i elementëve përbërës të strukturës së strategjisë, është bërë duke iu referuar Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030 (këtej e në vijim SND III).

Dokumenti shoqërohet nga dy anekse, pjesë përbërëse dhe integrale e dokumentit, që janë:

- Plani i veprimit dhe burimet financiare për zbatim - Është një dokument në format tabele, që paraqitet si aneks i dokumentit strategjik, ku detajohen masat dhe aktivitetet që ndërmerren në kuadër të çdo objektivi strategjik, duke përcaktuar institucionet përgjegjëse dhe kontribuese për zbatimin, veprimin konkret, afatin për ndërmarrjen e tij, kostot e nevojshme, etj.
- Pasaporta e treguesve/indikatorëve - Është një dokument në format matrice, që ndihmon procesin e monitorimit dhe matjes së progresit të strategjisë, duke dhënë për çdo tregues matës të qëllimeve dhe objektivave të përzgjedhur nga strategjia, kuptimin, lidhjen me dokumente të tjerë (si p.sh. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Acquis i BE), metodologjinë e matjes, të dhënat për matjen dhe burimin e tyre, vlerat e treguesit në momentin fillestar të strategjisë dhe ato të synuara, sipas viteve.

KUPTIMI DHE PËRMBAJTJA E ELEMENTEVE TË STRUKTURËS PËRBËRËSE TË NJË DOKUMENTI STRATEGJIK

KUPTIMI DHE PËRMBAJTJA E "PJESËS SË PARË: KONTEKSTI STRATEGJIK"

Pjesa e parë e një dokumenti strategjik, është "Konteksti strategjik". Ajo ka në përmbajtje të saj disa nënndarje apo krerë, si:

- Hyrja dhe Qëllimi i Dokumentit Strategjik;
 - Kuadri ligjor, institucional dhe lidhja me dokumentet e tjera strategjike;
 - Arritjet, analiza dhe sfidat;
 - Vizioni dhe misioni i dokumentit.
-
- Hyrja dhe Qëllimi i Dokumentit Strategjik - Kjo pjesë bën një përshkrimi të shkurtër të kontekstit historik të sektorit, duke evidentuar nevojën dhe qëllimin për të cilin është hartuar dokumenti. Në formulimin e këtij të fundit mbahet në konsideratë rëndësia që ai ka, në kuadër të arritjes së vizionit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim në fuqi, të procesit të integritimit në BE, si dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.
-

Shembull mbi kontekstin dhe qëllimin e SND III



SND III pasi sqaron fazat në të cilat ka kaluar reforma në drejtësi, dhe detyrat e prioritetet e secilës fazë e lidh nevojën e hartimit të strategjisë me qëllimin e përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga faza e tretë e Reformës në Drejtësi (konsolidimi i kuadrit institucional dhe përmirësimin e infrastrukturës së sistemit të drejtësisë) si dhe detyrimet që burojnë në kuadër të proceseve integruese (të specifikuar në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, Kapitulli 23 - Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore)

- Kuadri ligjor dhe institucional, lidhja me dokumentet e tjera strategjike

Në këtë pjesë, së pari renditet kuadri ligjor që rregullon sektorin/sectorët, përfshirë këtu edhe ligje të tjera që lidhen në mënyrë jo të drejtpërdrejtë e që ndikojnë në sektor. Kjo shoqërohet edhe me një përshkrim të institucioneve përgjegjëse që përfshihen në zbatimin, monitorimin, apo që në një mënyrë apo tjetër ndikojnë në sektor.

Së dyti, për të kuptuar drejt vizionin dhe objektivat ku duhet të orientohet sektori, bëhet ndërlidhja e sektorit dhe dokumentit strategjik me SKZHI në fuqi, me strategjitë e tjerë sektoriale apo ndërsektoriale, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Programin e Qeverisë, Raportet e Progresit të Komisionit Europian, Planin Kombëtar të Integritimit Europian në fuqi, raportet e hartuara nga organizatat ndërkombëtare lidhur me fushën, etj.

Shembull referuar SND III



SND III evidenton në mënyrë të detajuar dhe bën lidhjen e dokumentit me ligjet kombëtare që rregullojnë apo që ndikojnë në sektor, si dhe me SKZHI, PKIE, strategjitë e tjera kombëtare që lidhen me sektorin, Raport Progresin e Komisionit Europian, Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, etj.

- Arritjet, analiza dhe sfidat

Kjo pjesë si rregull ka për qëllim të paraqesë situatën aktuale të sektorit/sectorëve të mbuluar nga strategjia, duke u përpjekur të japë gjendjen aktuale në momentin e hartimit të strategjisë, arritjet në kuadër të reformave të ndërmarra deri në atë moment, si rezultat i strategjive të mëparshme, si dhe

problematikat e hasura së bashku me shkaqet respektive, të cilat përbëjnë sfida që në të ardhmen duhet të adresohen.

Për të evidentuar situatën aktuale, hartuesit nëpërmjet të dhënave cilësore dhe sasore (të marra nga monitorimi i strategjisë së mëparshme, objektivat afatmesme dhe afatgjata në kuadër të SKZHI, rekomandimet në kuadër të integritit evropian, raportimet në kuadër të Planifikimit Buxhetor Afatmesëm (PBA), raportet e ndryshme të organizmave ndërkombëtare) duhet të paraqesin gjendjen e sektorit, duke evidentuar arritjet dhe fushat që kanë nevojë për përmirësim. Analiza duhet të jetë koncize dhe të bazohet në të dhëna aktuale, të përditësuara. Analiza duhet të përfshijë metoda të ndryshme si ajo e vlerësimit të ndikimit të faktorëve politikë, ekonomikë, socialë, ligjorë, apo metodën SWOT (Strengths-Weaknesses-Opportunities-Threats) ku analizohen përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe risqet.

Në kuadër të qartësisë së sfidave të sistemit, duhet që të bëhet një përshkrim i saktë i problematikave të sektorit, bazuar në të dhëna dhe shkaqet prej nga vijnë. Evidentimi i saktë dhe i qartë i problematikave dhe shkaqeve, është i rëndësishëm për përcaktimin e qëllimeve të politikave dhe objektivave strategjike.

Shembull nga analiza e sektorit të SND III



SND III bën një analizë të sektorit të drejtësisë, reformave të ndërmarra, stadeve të reformës në drejtësi dhe gjithashtu jep rezultatet e monitorimit të SND II. Mbi bazën e tyre, dhe nivelit të përmbushjes së qëllimeve të politikave të SND II, janë identifikuar problematikat të cilat shërbejnë për të identifikuar vizionin e SND III dhe qëllimet e politikave të saj. Gjithashtu për evidentimin e sfidave ka një analizë të dokumenteve politike kombëtare apo ndërkombëtare që përshkruajnë detyrime për sektorin.

Koment: Në këtë rast do të ishte e rekomandueshme që analiza aktuale e sektorit, e mbështetur në rezultatet e monitorimit, do të duhej të ishte një analizë që ka përpunuar rezultatet vjetore të monitorimit duke përmbledhur rezultatet e arritura nga SND II gjatë viteve të zbatimit të saj. Rezultatet sipas viteve, të përdorura në këtë analizë, nuk japin një kornizë të qartë të gjendjes aktuale të qëllimeve të politikave. Gjithashtu evidentimi i arritjeve dhe sfidave të identifikuara do të duhej të kishte një mbështetje më të gjerë në shifra, që i referohen momentit të hartimit të dokumentit strategjik.

Gjithashtu evidentimi i problemeve dhe shkaqeve kërkon qartësi më të madhe, qoftë kjo edhe vizive. Në këtë mënyrë do të kuptohej më mirë konteksti i qëllimeve dhe objektivave strategjike.

- Vizioni dhe Misioni i dokumentit

Ky kre duhet të shprehë vizionin, qëllimet kryesore të politikës dhe treguesit/indiktorët kryesorë të strategjisë (indiktorë të impaktit, apo të rezultatit). Vizioni është një deklaratë që shpreh vizionin e Qeverisë sa i takon kuadrit strategjik. Vizioni duhet të jetë mjaftueshëm ambicioz për të orientuar zhvillimin e sektorit, por gjithashtu duhet të jetë realist dhe i mundshëm për t'u zbatuar. Ai duhet t'i përshtatet kohëzgjatjes së dokumenteve, të cilat janë së paku 5 vite. Si rregull vizioni duhet të jetë në përputhje me qëllimin strategjik të fushës, të shprehur në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim në fuqi. Deklarata e vizionit duhet të shkruhet në mënyrë të qartë dhe koncize të përmbledhur në një apo dy fjali.

Ndërkohë që vizioni është një deklaratë që tregon gjendjen se ku do të jetë sektori në fund të afatit të strategjisë, misioni përshkruan në mënyrë të përgjithshme hapat që do të ndërmerren për të arritur në atë vizion.

Duke qenë se vizioni do të përkthehet dhe materializohet në qëllimet e politikës në këtë seksion duhet të listohen qëllimet kryesore të politikës së strategjisë, si dhe treguesit /indiktorët kryesorë të strategjisë (tregues të ndikimit, apo të rezultatit), sipas atyre të përzgjedhur nga Pasaporta e Treguesve.

Shembull i Vizionit dhe Misionit të marrë nga SND III



Vizioni: "Shqipëria konsolidon arritjet e Reformës në sistemin e drejtësisë në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, me synimin për të rritur më tej efikasitetin e drejtësisë në përputhje me standardet europiane".

Misioni: "Avancimi strategjik i reformave në sistemin e drejtësisë, të ndërtuara mbi bazat e pavarësisë dhe paanshmërisë, që thekson rëndësinë e transparencës, përgjegjësisë dhe siguron akses universal, në përputhje me standardet më të mira europiane".

Koment: Vizioni është një deklaratë që i referohet në mënyrë shumë të përgjithshme vetëm efikasitetit të drejtësisë, i cili nuk është tipari i vetëm thelbësor i një drejtësie sipas standardeve. Ndërkohë ai duhet të përmbajë tiparet karakteristike të një sistemi drejtësie sipas standardeve europiane, si p.sh. pavarësia, eficienta, transparenca, aksesit, etj. të cilat reflektohen tek misioni i cili duket të jetë hartuar në mënyrë më të qartë. Gjithashtu deklarata e vizionit nuk përbën një sintezë të gjithë qëllimeve të politikave (shih më poshtë), tek të cilat si rregull ajo jetëzohet. Në këtë pjesë duhet të përmendeshin në mënyrë të përmbledhur (me nga një fjali) edhe qëllimet kryesore të politikës ku jetësohet vizioni, si dhe indikatorët kryesorë që matin ato.

Pyetje kontrolli për vlerësimin e pjesës së parë të dokumentit strategjik

- A përmban pjesa hyrëse në mënyrë të qartë dhe të përmbledhur kontekstin e sektorit të mbuluar nga strategjia?
- A përcaktohet në mënyrë të saktë qëllimi i dokumentit strategjik, duke e lidhur me gjendjen e sistemit, si dhe nevojën për avancim të mëtejshëm?
- A lidhet në mënyrë të qartë qëllimi i hartimit të dokumentit strategjik me detyrimet nga dokumentet kryesore strategjike, dhe ato të integritit në BE?
- A është listuar i gjithë kuadri ligjor që rregullon sektorin?
- A është evidentuar qartë kuadri ligjor që ndikon në sektor?
- A janë identifikuar saktë dhe në mënyrë tërësore institucionet që operojnë në sektor dhe përmbushin objektivat e strategjisë?
- A janë evidentuar në mënyrë të qartë dhe konkrete lidhja e strategjisë me dokumentet e tjera strategjike ekzistuese në rang kombëtar?
- A është evidentuar qartë dhe në mënyrë tërësore gjendja e të gjithë sektorit?
- A është mbështetur në shifra dhe të dhëna të sakta dhe të përditësuara gjendja e sektorit?
- A janë evidentuar në mënyrë të saktë arritjet? A mbështeten ato në të dhënat e periudhës pararendëse të strategjisë?
- A është mbështetur analiza në të dhëna nga raportet e monitorimit të strategjisë pararendëse?
- A është mbështetur analiza në dokumente si program politik, progres-raportet e BE, raportet e organizmave ndërkombëtare, raportet e PBA?
- A janë evidentuar në mënyrë të saktë dhe të qartë problemet e sektorit?
- A janë të përshkruara saktë shkaqet e problemeve?
- A evidentohen rrugët e zgjidhjes së problemeve?
- A është hartuar qartë dhe në mënyrë koncize deklarata e Vizionit?
- A është deklarata e Vizionit ambicioze dhe në përputhje me politikat qeveritare dhe nevojat e vendit?
- A është deklarata e Vizionit realiste dhe e arritshme për periudhën që mbulon strategjia?
- A përmban Misioni veprimtaritë e duhura që duhen ndërmarrë me qëllim arritjen e vizionit?
- A shoqërohet deklarata e Vizionit dhe Misionit me qëllimet kryesore të politikave?
- A shoqërohet deklarata e Vizionit dhe Misionit me indikatorët kryesore të strategjisë?

KUPTIMI DHE PËRMBAJTJA E "PJESËS SË DYTË – QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË STRATEGJISË"

Kjo pjesë përbën pjesën thelbësore të dokumentit strategjik. Që vizioni i strategjisë të jetësohet duhet që ai të zërthehet në politika, qëllimi i të cilave duhet të jetë përmbushja, në përfundim të kohëzgjatjes së strategjisë, e këtij vizioni. Në këtë pjesë të strategjisë renditen politikat që vlerësohen më të rëndësishme dhe të përshtatshme, në përmbushjen e vizionit në fund të periudhës. Politikat duhet të formulohen qartë, duke paraqitur qëllimin specifik të secilës politikë.

Çdo politikë duhet të shoqërohet me objektivat specifike të qëllimeve të politikës, rezultatet që priten nga arritja e objektivit, masat (veprimtaritë) që duhet të merren me qëllim arritjen e rezultateve, si dhe treguesit përkatës që masin performancën, që pritet nga ndërhyrja. Kjo pjesë ndjek një strukturë të tillë:

Shembull si strukturohen qëllimet e politikave dhe objektivat specifikë



- 1. Qëllimi i Politikës 1
 - 1.1 Objektivi Specifik 1 i Qëllimit të Politikës 1
 - Rezultatet e pritshme
 - Masat
 - Treguesit kryesorë
 - 1.2 Objektivi Specifik 2 i Qëllimit të Politikës 1
 - Rezultatet e pritshme
 - Masat
 - Treguesit kryesorë
 - 1.3etj
- 2. Qëllimi i Politikës 2
 - 2.1 Objektivi Specifik 1 i Qëllimit të Politikës 2
 - Rezultatet e pritshme
 - Masat
 - Treguesit kryesorë
 - 2.2.....
 - 2.3.....
- 3. Qëllimi i Politikës 3

Siç u theksua edhe më sipër, dokumenti strategjik si rregull jetëson vizionin e tij në disa politika, të cilat vlerësohen më të rëndësishme dhe relevante për përmbushjen e vizionit dhe misionit të strategjisë. Për të identifikuar qartë qëllimet e politikave, duhet të mbahen në konsideratë problematikat që ka sektori. Strategjia, si rregull përmban disa qëllime politikash, të cilat duhet të jenë në lidhje logjike me njëra-tjetrën. Qëllimet e politikave duhet të reflektojnë problemet e sektorit të evidentuara për zgjidhje, ku çdo problemi, duhet që t'i korrespondojë një qëllim politike. Qëllimi i politikës përshkruhet qartë dhe në mënyrë koncize.

Si rregull strategjia duhet të analizojë lidhjen e çdo qëllim politike me kapitullin përkatës të BE, sipas ndarjes që bën MSA, apo me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Ky informacion është i rëndësishëm për të kuptuar detyrimin përkatës që vjen nga proceset integruese, si dhe për të kuptuar që zgjidhja e problemeve, bëhet në përputhje me këto të fundit. Gjithashtu ky informacion shërben edhe për monitorimin e ecurisë së reformave në raport me proceset e integritit, si dhe dokumentin e Planit Kombëtar të Integritit Europian (PKIE). Qëllimi i politikës duhet të jetë në përputhje edhe me qëllimin e Deklaratave të Politikës së Programeve përkatëse, që paraqiten në Programin Buxhetor Afatmesëm për zbatimin e strategjisë sektoriale apo ndërsektoriale.

Shembull i qëllimeve të politikave të parashikuara në SND III



Qëllimi Politik 1: Konsolidimi dhe qëndrueshmëria e arritjeve të reformës në drejtësi në përputhje me standardet Europiane.

Qëllimi Politik 2: Forcimi i pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë

Qëllimi Politik 3: Rritja e efikasitetit të institucioneve në sistemin e drejtësisë.

Qëllimi Politik 4: Forcimi i cilësisë së drejtësisë.

Qëllimi Politik 5: Drejtësi më e afërt me qytetarët.

Koment: Presumohet që gjithë politikat në tërësi dhe koherencë mes tyre, të mundësojnë arritjen e vizionit strategjik të sektorit të mbuluar nga strategjia. Këto qëllime politikash janë të ndërlidhura me problemet dhe nevojat që paraqet situata aktuale. P.sh. evidentimi i dosjeve të prapambetura (njohur si backlogu) dhe kohëzgjatjes së afateve të gjykimit si problem, në pjesën e parë të dokumentit, shoqërohet me qëllimin e politikës 3, që reflekton gjendjen e synuar pas adresimit të problemit.

- Objektivi Specifik i Qëllimit të Politikës

Çdo qëllim politike shoqërohet me objektivat kryesore të politikës që parashikohen të arrihen nga institucionet përgjegjëse. Ndërsa Qëllimi i Politikës duhet t'i korrespondojë një problemi të sektorit dhe është një deklaratë që pasqyron rezultatin e zgjidhjes së këtij problemi, objektivi specifik duhet t'i referohet shkakut të problemit, dhe duhet të jetë një deklaratë që adreson shkakun e problemit.³ Objektivat duhen zgjedhur të tilla, në mënyrë që disa objektiva specifike, në koherencë mes tyre, të mundësojnë arritjen e qëllimeve të politikës. Objektivat duket të shprehen në mënyrë, që ti krijojnë mundësinë monitoruesit të vlerësojë dhe të masë ecurinë dhe progresin në lidhje me arritjen e qëllimit.

Objektivat duhet të jenë:

- specifike – që do të thotë të jenë konkrete, të pasqyrojnë një rezultat që kërkohet, i cili është i lidhur me zgjidhjen e problemit
- të matshme – që do të thotë se duhet të përzgjidhen në mënyrë të tillë që të mund të maten dhe të mundësojnë vlerësimin e progresit
- të arritshme – pra të shprehin se çfarë duhet të përmirësohet, për zgjidhjen e problemit
- realiste – që do të thotë se me mjetet dhe burimet në dispozicion të mund të jenë të realizueshme
- të kufizuara në kohë – që do të thotë që realizimi i objektivave të jetë i realizueshëm brenda afateve kohore të përcaktuara të strategjisë.⁴

Çdo objektivi specifik, kërkohet që të shoqërohet me një analizë, ku shprehet qartë konteksti i zbatimit. Në analizimin e objektivit duhet të:

- jepet lidhja me programin e qeverisë, prioritetet e ministrive, dokumente të tjerë strategjike për sektorin
- jepet lidhja (nëse ka) me plotësimin e kriterëve të një kapitulli apo nën-kapitulli të BE, sipas MSA
- të paraqesë shkurtimisht analizën e situatës dhe sfidat që paraqiten për të ardhmen, për të kuptuar qartë arsyen për të cilat objektivi është formuluar.
- sqarohet lidhja e objektivit specifik me programet buxhetore
- cilësohen institucionet kryesore që do të implementojnë objektivin.

[3] Zyra për Planifikim Strategjik e Qeverisë së Republikës së Kosovës, "Manual për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumenteve, strategjike dhe planeve të tyre të veprimit", Prishtinë, 2019, fq 48-50

[4] Ibid, fq 51

Shembull i objektivave specifike të qëllimit politik 2 të SND III



Qëllimi Politik 2 - Forcimi i pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë

Objektivi Specifik 2.1 - Garantimi i emërimeve dhe zhvillimit të karrierës së magjistratëve në sistemin e drejtësisë, bazuar në meritokraci.

Objektivi Specifik 2.2 - Forcimi i kapaciteteve institucionale, të magjistratëve edhe jo-magjistratëve për parandalimin dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e brendshme dhe të jashtme.

Objektivi Specifik 2.3 - Sigurimi i zbatimit të njëtrajtshëm të standardeve të ndarjes së rastësishme të çështjeve.

Objektivi Specifik 2.4 - Sigurimi që kontrollet e figurës dhe pasurisë në sistemin e drejtësisë kryhen në përputhje me standardet e vetting-ut.

Objektivi Specifik 2.5 - Përforcimi i mekanizmave të llogaridhënies së magjistratëve.

Koment: Objektivi specifik, si rregull lidhet me shkaqet e problemit të cilin e adreson politika. Nëse problemi i gjyqësorit është mungesa e pavarësisë dhe paanshmërisë në vendimmarrjet e gjyqësorit, qëllimi i politikës është i tillë që duhet të adresojë problemin dhe konkretisht forcimi i pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë. Shkaqet që çojnë në mungesën e pavarësisë dhe paanshmërisë janë të ndryshme. Secilit nga shkaqet e identifikuar duhet ti përkojë një objektiv specifik. Kështu, p.sh. një ndër shkaqet që ndikon në pavarësi, është ndikimi i brendshëm apo i jashtëm në proceset e emërimit dhe rritjes në karrierë, Objektivi specifik i cili adreson shkakun e këtij problemi është "Garantimi i emërimeve dhe zhvillimit të karrierës së magjistratëve në sistemin e drejtësisë, bazuar në meritokraci". Si rregull çdo objektiv specifik synon zgjidhjen e shkaqeve të problemit, të cilin synon ta adresojë politika përkatëse. Adresimi i të gjitha shkaqeve të problemit, në tërësinë e tyre, mundëson zgjidhjen e tij.

- Rezultatet

Siç e theksuam më sipër, objektivat duhet të jenë të arritshme dhe të matshme. Për pasojë ato duhet të shoqërohen më rezultatet e pritshme nga arritja e objektivave. Është e rëndësishme që rezultatet të kenë lidhje logjike me objektivin, dhe të jenë rrjedhojë e masave që do të merren për realizimin e tij. Rezultatet duhet të jenë të matshme, në mënyrë sasiore dhe të lidhen me vitet e implementimit të strategjisë.

Shembull i një rezultati të objektivit strategjik, marrë nga SND III



Objektivi strategjik: Sigurimi i aksesit në vendimet e gjykatave dhe qëndrueshmërisë së praktikave gjyqësore me qëllim përmirësimin e cilësisë së arsytimit të vendimeve

Rezultati: Deri në fund të vitit 2030, 100% e arkivave të gjykatave janë digjitalizuar, për të garantuar modernizimin e sistemit gjyqësor, për të lehtësuar aksesin në dokumente dhe për të përmirësuar eficiencën në menaxhimin e çështjeve

Koment: Çdo objektivi strategjik i korrespondon një rezultat i caktuar që pritet të vijë nga përmbushja e tij. Gjithë rezultatet e pritshme të objektivave specifike, nën një politikë, si rregull mundësojnë arritjen e qëllimit të politikës.

- Masat apo aktivitetet që duhet të ndërmerren

Objektivi specifik që të mund të sjellë rezultatin e pritshëm, duhet të shoqërohet me masa konkrete. Masat duhet të mundësojnë arritjen e rezultateve dhe përmbushjen e objektivit. Pra thënë ndryshe, të adresojnë problemin e sektorit, që pasqyrohet nëpërmjet qëllimit të politikës.

Masat duhet të jenë veprimtari, që duhet të ndiqen nga institucionet përgjegjëse. Ato mund të jenë të natyrave të ndryshme, si: ligjore, institucionale, politike, etj. që adresojnë shkaqet e problematikave të sektorit dhe që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me rezultatet e pritshme të identifikuara. Si rregull edhe masat vetë janë të zërthyer në aktivitete, të cilat janë veprime konkrete të detajuara që ndërmerren nga institucionet/individët në plotësim të masës.

Dokumenti, për çdo masë, jep emërtimin, përshkruan natyrën e masës dhe cilat rezultate pritet të sjellë zbatimi i saj, p.sh nëse masa është e lidhur me acquis e BE, data kur planifikohet të fillojë zbatimi i saj dhe data kur pritet të përfundojë ky zbatim. Për secilën masë parashikohen kostot në planin e veprimit.

Shembull i objektivit strategjik, rezultatit dhe masave respektive, marrë nga SND III



Objektivi strategjik 4.4: Sigurimi i aksesit në vendimet e gjykatave dhe qëndrueshmërisë së praktikave gjyqësore me qëllim përmirësimin e cilësisë së arsyetimit të vendimeve

Rezultati: Deri në fund të vitit 2030, 100% e arkivave dhe gjykatave janë digjitalizuar, për të garantuar modernizimin e sistemit gjyqësor, për të lehtësuar aksesin në dokumente dhe për të përmirësuar eficiencën në menaxhimin e çështjeve.

Masat:

4.4.1 Gjykata Kushtetuese përmirëson aksesin në praktikën e saj gjyqësore.

4.4.2 KLGJ-ja siguron publikimin dhe përmirëson kërkueshmërinë e vendimeve gjyqësore, veçanërisht të Gjykatës së Lartë.

4.4.3 SHM-ja ofron trajnime për hulumtimin dhe analizën e çështjeve gjyqësore.

4.4.4 GJL-ja vazhdon të unifikojë vendimet e gjykatave dhe si rrjedhojë praktika gjyqësore përmirësohet më tej.

4.4.5 Vlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve nga KLGJ-ja dhe KLP-ja, përfshin, ndër të tjera, standardet e arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

4.4.6 Sigurohet monitorim dhe vlerësim transparent i aktiviteteve të gjykatës.

Koment: Rezultati që synohet të arrihet nëpërmjet objektivit sigurohet nëpërmjet një sërë masash që duhet të ndërmerren nga institucionet.

P.sh., që të mundësohet rritja e aksesit në vendimet e gjykatave, duhet që gjykatat dhe organet qeverisëse, e Shkolla e Magjistraturës të marrin një sërë masash si më sipër, në mënyrë që deri në përfundim të periudhës së mbuluar nga strategjia (2030), 100% e arkivave të gjykatave të jenë digjitalizuar

Ndërkohë në përmbushje të masë 4.4.2 parashikohen një sërë aktiviteteve, si:

4.4.2.1 Analizë mbi gjendjen aktuale të publikimit dhe kërkueshmërisë së vendimeve të gjykatave duke përfshirë rekomandimet për krijimin e mjeteve të kërkimit të TI-së;

4.4.2.2 Raport mbi zbatimin e rezultateve të analizës.

4.4.2.3 Ri-dizenjimi i faqes zyrtare web të Gjykatës së Lartë me qëllim përmirësimin e kërkueshmërisë së vendimeve të Gjykatës së Lartë

4.4.2.4 Publikimi i vazhdueshëm i të gjithë vendimeve të Gjykatës së Lartë

- Treguesit (Indikatorët) kryesorë të performancës

Për të kuptuar ecurinë e zbatimit të strategjisë, si dhe për të vlerësuar dhe matur progresin e saj, përgjatë viteve të zbatimit të dokumentit strategjik, duhet të identifikohen treguesit matës. Treguesit matës të performancës, mund të përcaktohen në bazë të Qëllimit të Politikës (të cilët vlerësojnë impaktin ose rezultatet); Objektivit Specifik (të cilët masin rezultatet); apo në bazë të Rezultatit (të cilët masin produktin)⁵. Megjithatë, kryesisht preferohen tregues për qëllimet dhe objektivat, pasi produkti i masave apo aktiviteteve, si rregull duhet të përzgjidhet i tillë që të nënkuptohen⁶. Prandaj, përgjithësisht dokumenti strategjik si rregull ka dy lloje treguesish: treguesit e ndikimit dhe tregues të nivelit të rezultateve.

Treguesit për nga natyra mund të jenë sasiorë ose cilësorë. Treguesit sasiorë maten me numra, raporte ose përqindje dhe përdoren më shpesh, pasi janë më të lehta për t'u llogaritur dhe japin të dhëna më të qarta e që kuptohen më lehtë.⁷ Treguesit cilësorë, përshkruajnë nivelin e ndikimeve dhe rezultatet në mënyrë cilësore, duke u vlerësuar me (po/jo) ose vlerësim (nga 'e shkëlqyeshme' deri te 'dobët').⁸

Çdo objektivi specifik duhet t'i përgjigjet të paktën një tregues matës. Qëllimi i politikës mund të matet nëpërmjet treguesit të ndikimit ose të nivelit të rezultateve, ndërsa objektivi specifik mund të matet me treguesin e nivelit të rezultateve.

Treguesit, kryesisht ata sasiorë, llogariten mbi bazë të formulave të matjes. Për të vlerësuar rezultatet që dalin nga formula dhe për të kuptuar ecurinë, përgjatë viteve të strategjisë, duhet që për treguesin të përcaktohen vlerat bazë të cilat i korrespondojnë gjendjes në momentin e hartimit të dokumentit strategjik dhe vlerat e synuara të cilat shprehin gjendjen e synuar në momentin e përfundimit të periudhës që mbulon strategjia. Treguesit e dokumenteve strategjike duhet të kenë si rregull vlera të synuara, për çdo vit strategjik, në mënyrë që të arrihet të vlerësohet dhe matet ecuria e progresit. Këto vlera duhet të studiohen dhe të përpunohen në mënyrë të tillë që të jenë në përputhje me kërkesat që burojnë nga detyrime kombëtare e ndërkombëtare, mundësitë reale të përmbushjes, duke marrë për referencë krahasimore vende të tjera, rezultate të mëparshme, etj.⁹

[5] Zyra për Planifikim Strategjik e Qeverisë së Republikës së Kosovës, "Manual për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumenteve, strategjike dhe planeve të tyre të veprimt", Prishtinë, 2019, fq 52

[6] Po aty

[7] Po aty

[8] Po aty

[9] Po aty, fq 55

Shembull të treguesve cilësorë, sasiorë, të rezultatit apo impaktit marrë nga SND III



Tregues cilësor - Përfundimi i digjitalizimit të arkivave në gjykata

Tregues sasior - Përqindja e magjistratëve që ndjekin rregullisht trajnimet për të cilat janë për zgjedhur nga Shkolla e Magjistraturës.

Koment: Treguesi i parë vlerëson me po dhe jo realizimin e objektivit, ndërsa treguesi i dytë vlerëson dhe mat mbi bazë përqindjeje.

Qëllimi i Politikës 4 - Forcimi i cilësisë së drejtësisë

Objektivi strategjik 4.4: Sigurimi i aksesit në vendimet e gjykatave dhe qëndrueshmërisë së praktikave gjyqësore me qëllim përmirësimin e cilësisë së arsytimit të vendimeve

Rezultati: Deri në fund të vitit 2030, 100% e arkivave të gjykatave janë digjitalizuar, për të garantuar modernizimin e sistemit gjyqësor, për të lehtësuar aksesin në dokumente dhe për të përmirësuar eficiencën në menaxhimin e çështjeve.

Treguesi: Përfundimi i digjitalizimit të arkivave në gjykata

Koment: Treguesi i mësipërm është një tregues impakti, pasi vlerëson impaktin në përmbushjen e qëllimit të politikës

Qëllimi politik 1: Konsolidimi dhe qëndrueshmëria e arritjeve të reformës në drejtësi në përputhje me standardet europiane.

Objektivi specifik 1.3. - Ruajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapacitetit profesional, pavarësisë dhe efikasitetit të organeve të qeverisjes së drejtësisë.

Treguesi: Përqindja këshilltarëve/stafit administrativ të KLGJ-së dhe KLP-së të trajnuar për çështje që lidhen me detyrat e tyre funksionale.

Koment: Treguesi më sipër është tregues rezultati. Treguesi jep një vlerë në përqindje që është rezultat i raportit mes numrit të këshilltarëve/administratës së KLGJ-së/ KLP-së që janë trajnuar mbi detyrat e tyre funksionale në raport me numrin total të këshilltarëve/administratës së KLGJ-së/ KLP-së përgjatë vitit të monitorimit.

Pyetje kontrolli për vlerësimin e qëllimeve politike, objektivave, masave rezultateve dhe treguesve

- A janë identifikuar saktë politikat dhe qëllimet e politikave të sektorit?
- A janë qëllimet e politikave pasqyrim i problemeve kryesore të sektorit të evidentuar në pjesën e parë të dokumentit strategjik?
- Qëllimet e politikave, në tërësinë e tyre dhe në koherencë me njëra-tjetrën, a mundësojnë arritjen e vizionit të dokumentit strategjik?
- Objektivat specifike a janë në koherencë me qëllimin e politikës përkatëse, nën të cilën qëndrojnë?
- Objektivat specifike, në tërësinë e tyre a mundësojnë arritjen e qëllimit të politikës, pjesë e së cilës janë?
- Rezultatet a janë rrjedhojë logjike e pritshme e përmbushjes së objektivave specifike?
- A janë pasqyruar në mënyrë të saktë dhe të plotë rezultatet e pritshme?
- A janë identifikuar saktë masat që duhet të ndërmerren për arritjen e rezultateve të pritshme?
- A janë të plota masat e përzgjedhura, dhe a mundësojnë ato në tërësinë e tyre arritjen e rezultateve?
- A pasqyrojnë aktivitetet e përzgjedhura, veprimtaritë konkrete në përmbushje të masës?
- Treguesit e përzgjedhur a vlerësojnë dhe masin progresin e objektivit specifik?
- A janë përzgjedhur në mënyrë të plotë treguesit matës të objektivit specifik?
- A masin treguesit progresin e bërë në drejtim të arritjes së rezultatit?
- A janë të matshëm nga pikëpamja sasimore apo cilësore treguesit?
- A janë identifikuar treguesit e impaktit dhe rezultatit, të cilat vlerësojnë ecurinë e progresit në përmbushje të qëllimit?
- A janë identifikuar në mënyrë të saktë treguesit e rezultateve, që masin dhe vlerësojnë përmbushjen e objektivit?
- A janë përpiluar qartë treguesit e performancës?
- A janë përcaktuar drejt formulat e llogaritjes së treguesve sasiorë?
- A janë identifikuar vlerat bazë të treguesve?
- A janë të përcaktuara vlerat e synuara për çdo vit?

KUPTIMI DHE PËRMBAJTJA E "PJESËS III – PROJEKTET/PROGRAMET KOMBËTARE TË ZHVILLIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

Kjo pjesë e strategjisë ndërlihd qëllimet e politikave të strategjisë me projektet ose programet kombëtare, kur përmbushja e këtyre të fundit do të kontribuojë në zbatimin e strategjisë. Kjo pjesë plotësohet nëse në momentin e hartimit të strategjisë ka projekte apo programe kombëtare të kësaj natyre, pasi jo çdo dokument detyrimisht ka një kre të tillë. Nëse plotësohen, listohen dhe përshkruhen projektet strategjike kombëtare që parashikohen të zbatohen lidhur me këtë strategji, ose projektet strategjike për realizimin e të cilave kontribuojnë masat e parashikuara në këtë strategji.

Shembull për SND III



SND III nuk ka një kre të tillë, sa kohë që hartuesit nuk kanë evidentuar ekzistencën e projekteve apo programeve për zhvillimin e strategjisë.

KUPTIMI DHE PËRMBAJTJA E "PJESËS IV: PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, KOORDINIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Kjo pjesë lidhet me zbatimin dhe monitorimin e strategjisë. Në të përshkruhen plani i zbatimit të strategjisë, përgjegjësitë e institucioneve që marrin pjesë dhe organizimi i punës gjatë zbatimit, raportimit dhe monitorimit të dokumentit.

Në këtë pjesë duhet të shpjegohen:

- Përgjegjësia e institucioneve për zbatim - Në këtë pjesë përshkruhet kuadri institucional ekzistues i sektorit, duke dhënë rolet dhe funksionet e institucioneve përgjegjëse lidhur me zbatimin e strategjisë.
- Llogaridhënia dhe koordinimi - Në këtë pjesë përshkruhen në mënyrë të detajuar identifikimi i strukturave përgjegjëse dhe organizimi i punës lidhur me mbledhjen e të dhënave, monitorimin, mënyrën e raportimit dhe konsultimit të raporteve të monitorimit.

- **Monitorimi dhe Raportimi** - Përshkruhen përgjegjësitë institucionale të lidhura me monitorimin dhe raportimin. Në të jepen afatet e monitorimit, hapat që duhet të ndjekin strukturat përgjegjëse për hartimin e raportit të monitorimit, strukturat përgjegjëse raportuese, mënyra dhe afatet e raportimit, konsultimi i raporteve të monitorimit.
- **Vlerësimi** - Në këtë pjesë parashikohet mundësia dhe afati i vlerësimit të ecurisë së strategjisë, me qëllim ndryshimin, heqjen, shtimin e masave, apo dhe objektivave specifike, nën qëllimet strategjike bazë të dokumentit.

Shembull për SND III



SND III ka të përcaktuar në kreun respektiv, në mënyrë të detajuar, përgjegjësitë e institucioneve zbatuese, mënyrën e organizimit të punës lidhur me mbledhjen e të dhënave, raportimin, përpunimin e tyre, monitorimin dhe afatet respektive të monitorimit, hartimin e raporteve monitoruese, konsultimin dhe mundësinë e vlerësimit të dokumentit.

Pyetje kontrolli për vlerësimin e përgjegjësisë së institucioneve, llogaridhënies, monitorimit

- A janë identifikuar institucionet përgjegjëse dhe ato kontribuese në zbatimin e strategjisë?
- A janë përshkruar rolet konkretë të institucioneve përgjegjëse dhe kontribuese në zbatim?
- A përshkruhet mënyra e organizimit të punës lidhur me krijimin e të dhënave, përpunimin, apo raportimin?
- A janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për monitorimin, përbërja e tyre, detyrat konkrete, mënyra e organizimit të punës së tyre për mënyrën e mbledhjes, përpunimit të të dhënave?
- A janë përcaktuar afate periodike për monitorimin dhe hartimin e raporteve respektive?
- A është përcaktuar mënyra e raportimit dhe konsultimit të raporteve të monitorimit?
- A është parashikuar mundësia dhe afati i vlerësimit të ecurisë së strategjisë, me qëllim përmirësimin e dokumentit?

KUPTIMI DHE PËRMBAJTJA E "PJESËS V – ANALIZA E BUXHETIT"

Kjo pjesë e strategjisë analizon në mënyrë të detajuar kostot dhe efektin financiar të saj. Analiza parashikon kostot për çdo masë të ndërmarrë sipas planit të veprimit, duke llogaritur totalin e buxhetit që duhet për implementimin e strategjisë (në shifra dhe %), të specifikuar sipas viteve që shtrihet strategjia, si dhe sipas Qëllimit të Politikave. Analiza parashikon qartë burimet e financimit (buxheti apo donacion), si dhe e detajon buxhetin, sipas natyrës së shpenzimit (korrente apo kapitale).

Analiza në këtë pjesë, paraqitet në formë narrative, grafike dhe tabelare, duke dhënë buxhetimin në total për 3 vitet e para të PBA. Për vitet që mbulohen nga PBA në fuqi në kohën e hartimit të strategjisë, mbulimi me financim i kostove të strategjisë duhet të jetë i plotë (pra 100%) dhe pa boshllëk financiar, duke specifikuar përqindjen e mbulimit nga PBA dhe atë nga donatorët. Për vitet që nuk mbulohen nga PBA në fuqi, analiza paraqet një projeksion për burimet e mbulimit të shpenzimeve, ku mund të parashikohet dhe hendeku financiar.

Shembull mbi mënyrën e buxhetimit nga SND III



Qëllimi i Politikave	Natyra/ Tipologjia e Kostove	Kostoja Totale	Kostot e Planifikuara	Kosto për tu	Hendeku Financiar
		2024-2030	PBA 2024-2026 Buxheti & Donator	Planifikuar në Buxhetin 2027-2030	2024-2030
Qëllimi i Politikës 1. Konsolidimi dhe qendrueshmëria e arritjeve të reformes në drejtësi në përputhje me standartet Evropiane	Korrente	429,547,445	266,921,855	160,225,590	2,400,000
	Kapitale	0	0	0	
Qëllimi i Politikës 2: Forcimi i pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë	Korrente	449,795,730	216,440,830	196,406,760	36,948,140
	Kapitale	0	0	0	
Qëllimi i Politikës 3. Rritja e efikasitetit të institucioneve në sistemin e drejtësisë	Korrente	1,114,311,091	492,788,969	490,738,422	192,783,700
	Kapitale	1,799,001,000	1,737,001,000	0	
Qëllimi i Politikës 4. Forcimi i cilësisë së drejtësisë	Korrente	150,476,249	64,382,668	81,693,581	188,400,000
	Kapitale	184,000,000	0	0	
Qëllimi i Politikës 5. Drejtësi më e afërt me qytetarët.	Korrente	340,717,455	75,627,267	209,330,188	55,760,000
	Kapitale	0	0	0	
TOTALI [Leke]		4,467,848,970	2,853,162,589	1,138,394,541	476,291,840
TOTALI [Euro] <i>1 euro 105 Leke</i>		42,550,943	27,172,977	10,841,853	4,536,113

Pyetje kontrolli për hartimin e pjesës së buxhetimit të strategjisë

- A janë parashikuar drejt kostot totale të zbatimit të strategjisë?
- A janë llogaritur në mënyrë të detajuar kostot sipas qëllimeve, objektivave dhe masave?
- A janë llogaritur dhe evidentuar të ndara kostot korrente dhe kapitale, në total dhe për çdo qëllim politike?
- A janë evidentuar burimet e financimit buxhet/donacion, në mënyrë të detajuar për çdo qëllim politike?
- A është në koherencë me parashikimet e PBA në fuqi kostimi i strategjisë për 3 vitet e para të zbatimit?
- A ka një projeksion për burimet e financimit në vitet e tjera, pas trevjeçarit të parë?
- A ka hendek financiar të parashikuar për vitet pas trevjeçarit të parë? Sa është ai në raport me vlerën e mbuluar për vitet ku parashikohet hendek?
- A janë të paraqitura në formë tabelare dhe grafike të dhënat e mësipërme lidhur me kostimin?

KUPTIMI DHE PËRMBAJTJA E “PLANIT TË VEPRIMIT”

Plani i veprimit për zbatimin e dokumentit strategjik, përgatitet dhe miratohet së bashku me të dhe në çdo rast bën pjesë në dokumentet që e shoqërojnë atë si aneks. Plani i veprimit është dokumenti ku specifikohen masat konkrete që duhet të ndiqen nga institucionet përgjegjëse në zbatim të strategjisë, si dhe afatet brenda të cilave duhet të kryhen këto masa.

Plani i veprimit përgatitet në formë të një tablele që pasqyron: qëllimin e politikës, objektivat specifike, rezultatet e pritshme. Për secilin objektiv, Plani i Veprimit detajon masat, aktivitetet, institucionin përgjegjës, institucionin kontribues, afatin e fillimit të aktivitetit dhe atë të përfundimit. Plani i veprimit duhet të mbulojë një periudhë 3-vjeçare të zbatimit, me mundësinë e rishikimit. Plani i Veprimit paraqitet gjithashtu dhe i kostuar, duke detajuar kostot specifike për çdo objektiv, të parashikuar për zbatim.

Shembull i formatit dhe përmbajtjes së Plan Veprimit të SND III



Plani Veprimit "Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë" 2024-2030						
Qëllimi i Politikës 1 - Konsolidimi dhe qëndrueshmëria e arritjeve të reformës në drejtësi në përputhje me standardet europiane.						
Objektivi Specifik 1.1:		Përditësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi në përputhje me parimet e pavarësisë, llogaridhënies, efikasitetit, cilësisë dhe sigurimi i harmonizimit të legjislacionit shqiptar me <i>acquis</i> të BE-së.				
<u>Rezultatet e pritshme:</u>		Deri në fund të vitit 2030 janë zbatuar 100% e rekomandimeve të raporteve analitike të institucioneve mbi problematikat e zbatimit të ligjeve të reformës në drejtësi Deri në fund të vitit 2030 ligji vendas është përafëruar të paktën "pjesërisht" me 40 akte ligjore të BE-së.				
MASA	AKTIVITETE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONI KONTRIBUES	AFATI FILLIMIT	AFATI PËRFUND	
1.1.1 Koordinimi i zhvillimit dhe zbatimit të politikave shtetërore në lidhje me rritjen e pavarësisë, përgjegjëshmërisë, cilësisë dhe efikasitetin e drejtësisë.	1.1.1.1 Zbatimi i angazhimeve të ndërmarra në SND 2024-2030, Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës nga institucionet zbatuese dhe hartimi i Raporteve periodike të monitorimit sipas përcaktimeve ligjore	MD, Institucionet zbatuese të SND 2024-2030 dhe Udhërrëfyesit të Shtetit të së Drejtës		2024	2030	
	1.1.1.2 Zhvillimi i takimeve periodike nga ana e MD lidhur me pasqyrimin e gjetjeve të raporteve të monitorimit dhe hapave që do të ndiqen në të ardhmen	MD	Institucionet zbatuese të SND 2024-2030 dhe Udhërrëfyesit të Shtetit të së Drejtës		2024	2030
	1.1.1.3 Mbledhja dhe analizimi i të dhënave statistikore me qëllim marrjen e vendimeve mbi politikat e përgjithshme në sektorin e drejtësisë	MD	Institucionet zbatuese të SND 2024-2030 dhe Udhërrëfyesit të Shtetit të së Drejtës		2024	2030
	1.1.1.4 Bashkëpunimi me KLGJ dhe KLP për hartimin, miratimin dhe zbatimin prej këtyre të fundit të planeve strategjike për sistemin gjyqësor dhe për sistemin e prokurorisë, në përputhje me <i>acquis</i> e BE-së dhe standardet europiane dhe që forcojnë më tej parimet e reformës në drejtësi të vitit 2016	KLJGJ, KLP	MD		2024	2030

Pyetje kontrolli lidhur me planin e veprimit

- A është hartuar në mënyrë tabelare plani i veprimit?
- A ka ai të shpjeguar për çdo masë dhe aktivitet, që qëndron nën objektivin e një qëllimi politike, organin përgjegjës për zbatim dhe atë kontribues?
- A janë të detajuara masat në aktivitete konkrete në përmbushje të tyre?
- A janë të për zgjedhura drejt aktivitetet në zbatim të masës?
- A janë evidentuar të plota aktivitetet brenda secilës masë?
- A është vendosur për çdo aktivitet data e fillimit dhe e përfundimit?
- A shoqërohet strategjia me një variant të kostuar të planit të veprimit?

KUPTIMI DHE PËRMBAJTJA E "PASAPORTËS SË TREGUESVE"

Pasaporta e treguesve, është dokument, në formën e një matrice, e cila shërben për të matur progresin e objektivave apo qëllimeve të dokumentit strategjik. Ajo përgatitet dhe miratohet së bashku me strategjinë dhe bën pjesë në dokumentet që e shoqërojnë atë si aneks. Pasaporta përshkruan të gjitha detajet që lidhen me treguesit matës të saj, duke u ardhur në ndihmë organeve që mbledhin të dhënat, atyre raportuese dhe monitoruese për matjen e progresit të zbatimit të strategjisë, duke ofruar më pas mundësinë e identifikimit të mangësive dhe sfidave potenciale.

Në të paraqiten të gjithë treguesit e përcaktuar në përmbajtjen e strategjisë, duke dhënë për secilin prej tyre emërtimin, përshkrimin, natyrën e treguesit dhe relevancën e tij, lidhjen me SKZHIE, lidhjen me qëllimet apo objektivat e dokumentit strategjik, lidhjen me acquis, të dhënat që duhet të mblidhen për vlerësimin dhe matjen e tij, burimin e të dhënave, periodicitetin e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave, formulën e matjes/llogaritjes, vlerën bazë dhe vlerën e synuar për çdo vit, lidhjen me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Shembull i formatit të pasaportës, referuar një treguesi të saj, marrë nga SND III



PASAPORTA E TREGUESVE		
Emri i Treguesit	1. Treguesi mund të jetë një Tregues i SKZHI (plotësoni kolonat 4, 5); 2. Treguesi mund të jetë një Tregues i një Strategjie Sektoriale / Ndërsektoriale në nivelin politik (plotësoni kolonat 3,6); 3. Treguesi mund të jetë një Tregues i një Strategjie Sektoriale / Ndërsektoriale në nivelin specifik të objektivit (plotësoni kolonat 3,6,7).	Raporti i dosjeve të ekzekutuara me dosjet e regjistruara (%).
Lloji i Treguesit	Niveli i Lartë / Ndikimi / Rezultatet /	Ndikimi/ Rezultati
Emri i Dokumentit	Dokumenti strategjik ku krijohet treguesi	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë III 2024-30
Lidhja me SKZHIE (Shtylla / Kolona Nr.)	1. ANËTARSIA NË BE; 2. QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT; 3. RRITJA PËRMES STABILITETIT MAKRO-EKONOMIK DHE FISKAL; 4. RRITJA EKONOMIKE PËRMES RRITJES SË KONKURENCËS DHE INOVACIONIT; 5. INVESTIMET NË KAPITAL NJEREZOR DHE SOCIAL; 6. RRITJA PËRMES PËRDORIMIT TË QËNDRUESHËM TË BURIMEVE DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT.	Shtylla 1 "Anëtarësia në BE". Shtylla 2 "Mirëqeverisja, Demokracia dhe Shteti i së drejtës".
Qëllimi / Objektiv Strategjik në SKZHIE	Emërtimi siç është në "Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim". Referohu dokumentit Exel "Hartimi i SKZHI_MTBP për IPSIS", Kolona 4.	Seksioni 8.1 i SKZHIE II "Reformimi i Sistemit të Drejtësisë".



Shembull i formatit të pasaportës, referuar një treguesi të saj, marrë nga SND III

Qëllimi i politikës përkatëse	1. Emërtimi si në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Referojuni Dokumentit Excel "Mapping NSDI_MTBP for IPSIS", Kolona 17. 2. Kur nuk ka një Strategji, titulli vendoset siç është në SKZHI në dokumentin "Hartimi i NSDI_MTBP për IPSIS", Kolona 7.	QËLLIMI POLITIK 3: Rritja e efikasitetit në gjykata dhe prokurori në sistemin e drejtësisë.
Objektivi specifik me të cilin lidhet treguesi	Kjo kolonë plotësohet në rastin e treguesve të performancës për secilin objektivi specifik brenda një politike. "Hartimi i SKZHI_MTBP për IPSIS", Kolona 24.	OBJEKTIVI SPECIFIK 3.1 - Përmirësimi i kapacitetit të KLGJ dhe gjykatave, përfshirë GJL, për zbatimin e masave që rrisin efikasitetin.
Relevanca e Treguesit	Korniza e politikave / Sektori / Akti Ligjor / Rregullorja / Punësimi / Prona / Masat zbatuese, etj.	Masa zbatuese
Lidhje me Acquis Communautaire	(i) rëndësishëm për monitorimin e Planit Kombëtar për Integrimin në BE (NPEI) dhe përparësitë e qeverisë); (ii) nëse rezultati lidhet me acquis të BE (CELEX, Emërtimi).	Kapitulli 23 'Gjyqësori dhe të drejtat themelore' dhe nenin 78 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit midis Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare dhe BE dhe, anëtarëve dhe Republikës së Shqipërisë, "Rifuqizim i institucioneve dhe shtetit të së drejtës". Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës – Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore".
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	p.sh. Raportet e vlerësimit të përgatitura nga Njësia e Planifikimit Strategjik, Institucioni, faqet e internetit, etj.	Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit
Institucionet përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave	Institucioni që krijon dhe monitoron treguesin	MD
	Institucionet pjesëmarrëse	Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit
	Përkrahuri metodologjinë e matjes së treguesit	Treguesi synon të masë numrin e titujve ekzekutiv të ekzekutuar nga Zyrat Përbarimore Vendore/ Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit në raport me numrin total të çështjeve të regjistruara për ekzekutim, të shprehur në përqindje. Rritja e vlerës së raportit gjatë kohëzgjatjes së SND III është tregues i rritjes së efikasitetit të ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore. Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit do të raportojë raportin (%) ndërmjet çështjeve të ekzekutuara nga Zyrat Përbarimore Vendore dhe numrin total të çështjeve për ekzekutim gjatë periudhës raportuese (dmth. çështjet e regjistruara gjatë vitit të raportimit + çështjet e mbartura në fillim të vitit të raportimit). Treguesi synohet të ketë trend rritës progresiv sipas targeteve të përcaktuara më poshtë, duke marrë si vlerë bazë vitin 2024. Vlera e treguesit do të llogaritet sipas formulës: Vlera e treguesit = Nr i çështjeve të ekzekutuara / (Nr i çështjeve të regjistruara gjatë vitit 202x + Nr i çështjeve të mbartura në 1 Janar të vitit 202x) * 100.
Frekuenca e matjes	Frekuenca për vlerën e synuar sipas strategjisë	Vjetore
	Frekuenca e matjes për vlerën aktuale	Vjetore

Shembull i formatit të pasaportës, referuar një treguesi të saj, marrë nga SND III



Natyra e Treguesit: Kumulative / Rritëse	Rritje - Treguesit e një natyre rritëse (në rritje) synojnë të raportohen për secilën periudhë raportuese vetëm në vlerën e progresit të bërë gjatë periudhës aktuale të raportimit. Një shembull i një treguesi në rritje mund të jetë një projekt për të kryer disa ngjarje trajnimi dhe treguesi është "numri i trajnimeve të përfunduara". Për treguesin e përmendur, është më e përshtatshme të raportohet vlera e progresit të bërë vetëm në periudhën aktuale të raportimit. Kumulative - Për disa tregues, është më e përshtatshme të raportohet vlera totale e treguesit për secilën periudhë raportuese sesa mënyra se si ka ndryshuar vlera që nga periudha e fundit e raportimit. Një shembull mund të jetë një projekt rugor nga pika A në pikën B. Treguesi është "% e punës së përfunduar" dhe është vendosur të raportojë të dhënat në baza tremujore. Për ekspertin i cili duhet të raportojë një vlerë në tregues çdo tremujor, është më lehtë të raportosh vlerën e datës së fundit sesa progresin e bërë nga treguesi në bazë tremujore.	Rritje
Hyrja direkte ose e përbërë	Vlerat e treguesve "Të përbërë" llogariten automatikisht bazuar në treguesit e tjerë. Treguesit me hyrje "Direkte" janë ata për të cilët të dhënat futen manualisht nga përdoruesi i sistemit.	Direkt
Formula e llogaritjes	Kjo është vetëm për treguesit e përbërë. I jepet formula se si të llogaritet vlera e këtyre treguesve.	
Ndarja e të dhënave (për treguesit e përbërë)	Niveli një Niveli dy Niveli tre	E pazbatueshme E pazbatueshme E pazbatueshme
Theksoni drejtimin e ndryshimit / trendit të performancës	Vlerat në dispozicion po rriten ose zvogëlohen. Kjo fushë tregon nëse rritja ose zvogëlimi i vlerës së treguesit do të konsiderohet një ndryshim pozitiv. Kjo fushë do të përdoret në seksionin e analizës për të llogaritur% e saktë të performancës. Një shembull i një treguesi zbritës mund të jetë numri i aksidenteve automobilistike. Për këtë tregues performanca do të llogaritet me këtë formulë = (Synimi * 100) / Vlera aktuale. Për treguesin rritës Performanca = (Vlera e tanishme * 100) / Synimi.	Trend rritës (arritje ose tejkalim i targetit vjetor)
Vlerat bazë	Viti Vlera	2024 Do të matet për herë të parë në vitin 2024
Vlera e synuar	Viti dhe vlera Viti dhe vlera Viti dhe vlera Viti dhe vlera Viti dhe vlera Viti dhe vlera Viti dhe vlera	2024 2025: 2024+5% 2026: 2024+10% 2027: 2024+15% 2028: 2024+20% 2029: 2024+25% 2030: 2024+30%
Synimi i rishikuar:	Viti dhe vlera	Për t'u vendosur
Vlera aktuale bazë:	Viti dhe vlera	Për t'u vendosur
OZHQ - Zhvillimi i Qëndrueshëm i OKB Titulli i Qellimit	Specifikoni cilin OZHQ (objektiv) dhe cilin tregues global i referohet	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2015 – 2030 (OZHQ 16) Promovimin e një shoqërie paqësore dhe gjithëpërfshirëse që garanton zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe synon ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.
Vlera e synuar e treguesit OZHQ	Viti dhe vlera	Treguesit e OZHQ 16.3, 16.6, 16.7 e 16.10 (Numri / Përqindja / Teksti)

Në lidhje me treguesin, nga Pasaporta e Treguesve, monitoruesi merr gjithë informacionin e nevojshëm që i duhet për matjen dhe vlerësimin. Konkretisht, nëse i referohemi shembulli të mësipërm, monitoruesi:

- merr informacion për emërtimin dhe kuptimin e këtij treguesi, si dhe natyrën e tij (impakti / rezultati)

Në rastin konkret kupton çfarë mat konkretisht, çfarë vlerëson shifra që rezultojnë, si e vlerëson ajo progresin e qëllimit apo objektivit të strategjisë



- identifikon objektivin specifik dhe/ose qëllimin e politikës, progresin dhe ecurinë e së cilës vlerëson dhe mat ky tregues

Në rastin konkret treguesi vlerëson dhe mat qëllimin e politikës 3 dhe objektivin specifik 3.1



- kupton lidhjen e tij me dokumentet e tjerë si SKZHI, Acquisi BE-së, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Në rastin konkret Pasaporta jep konkretisht ndërlidhjen e treguesit me qëllimet dhe objektivat e SKZHI, Objektivat dhe treguesit e OZHQ, me kapitujt përkatës të MSA



- njihet me burimin e të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës, institucionet përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, frekuencën e matjes.

Në rastin konkret monitoruesi kupton se institucioni ku gjendet e dhëna është Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit dhe ajo mund të gjendet në raportet e vlerësimit të përgatitura nga Njësia e Planifikimit Strategjik, në vetë institucionin, në faqet e internetit, etj.. Kjo e dhënë mbledhet gjithashtu edhe nga Ministria e Drejtësisë që ka për detyrë monitorimin dhe vlerësimin e treguesit.



- njihet me metodologjinë e matjes dhe konkretisht, çfarë mat dhe vlerëson, cila është formula përkatëse, si llogaritet rezultati i saj, të dhënat që i duhen për të aplikuar formulën e llogaritjes.

Në rastin konkret monitoruesi kupton se treguesi mat numrin e titujve ekzekutiv të ekzekutuar nga Zyrat Përmbartimore Vendore/ Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit në raport me numrin total të çështjeve të regjistruara për ekzekutim, të shprehur në përqindje. Rritja e vlerës së raportit gjatë kohëzgjatjes së SND III është tregues i rritjes së efikasitetit të ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore.



Monitoruesi merr informacion për formulën e matjes dhe konkretisht:
 Vlera e treguesit = Nr i çështjeve të ekzekutuara / (Nr i çështjeve të regjistruara gjatë vitit 202x + Nr i çështjeve të mbartura në 1 Janar të vitit 202x) * 100.

Monitoruesi identifikon të dhënat që i duhen për aplikimin e formulës dhe konkretisht: Numrin e çështjeve të ekzekutuara përgjatë vitit x; Numrin e çështjeve të regjistruara gjatë vitit të monitorimit; si dhe Numrin e çështjeve të mbartura në atë vit.

Kupton se të dhënat duhet të mbahen dhe të përpunohen mbi baza vjetore, kupton frekuencën e matjes që gjithashtu është vjetore.

- vlerat bazë dhe vlerat e synuara, në mënyrë që të vlerësojë ecurinë dhe progresin sipas targetit të vendosur në momentin e hartimit

Në rastin konkret duke qenë se viti i parë i zbatimit është 2024, vlera bazë do i referohet këtij viti. Ajo do të përcaktohet në momentin konkret të fillimit të zbatimit të dokumentit. Vlerat e synuara për çdo vit, kanë trend rritës, referuar vlerës fillestare dhe konkretisht 2025: 2024+5%, 2026: 2024+10%, 2027: 2024+15%, 2028: 2024+20% 2029: 2024+25%, 2030: 2024+30%



- nëpërmjet krahasimit të rezultatit, monitoruesi vlerëson konkretisht progresin dhe përpqet që nga informacioni i marrë nga institucioni zbatues apo monitorues të kuptojë arsyet e mosrealizimit të vlerës së synuar, problemet e hasura, shkaqet e problemit, me qëllim dhënien e opinionëve për zgjidhje.

Listë kontrolli për vlerësimin e hartimit të pasaportës të treguesve

- A është pasaporta e treguesve në formatin e një matrice?
 - A jep pasaporta emërtimin e saktë të treguesit dhe kuptimin e tij, duke shpjeguar arsyen pse vendoset dhe çfarë mat?
 - A jep pasaporta e treguesve ndërlidhjen me qëllimin e politikës dhe objektivin specifik të cilin mat?
 - A përcakton pasaporta natyrën e treguesit (Ndikimi / Rezultati, apo Kumulative / Rritëse)?
 - A përcaktohet saktë metodologjia e matjes?
 - A përcaktohet formula e matjes së treguesit?
 - A përcaktohet periodiciteti i matjes dhe a është ai i mundshëm për t'u matur në atë afat?
 - A përkon emërtimi i treguesit me metodologjinë dhe formulën e matjes?
 - A identifikohen saktë të dhënat që duhen për matje dhe a ka kapacitete/mjete për mbledhjen dhe përpunimin e tyre sipas formulës?
 - A janë evidentuar qartë burimet nga ku mund të merren të dhënat (p.sh. institucione, dokumente, faqe zyrtare)?
 - A është e përcaktuar vlera bazë dhe vlera e synuar për çdo tregues?
 - A përshkruan pasaporta lidhjen me objektivat dhe qëllimet e SKZHI?
 - A përshkruan pasaporta lidhjen me objektivat dhe treguesit e OZHQ?
 - A përshkruan pasaporta lidhjen me kapitullin konkret të MSA-së, Udhërrëfyesit, Acquis?
-

MONITORIMI I ZBATIMIT TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

MONITORIMI I BRENDSHËM

Që një dokument strategjik të zbatohet në mënyrë efektive dhe të sjellë impaktin e synuar në sektor, është e rëndësishme që përveç zbatimit rigoroz të masave dhe aktiviteteve nga institucionet përgjegjës, të bëhet dhe një monitorim dhe raportim në kohë i ecurisë së zbatimit. Për këtë është e rëndësishme që monitorimi dhe hartimi i raportit përkatës të bëhet rregullisht sipas afateve të përcaktuara në vetë dokumentin strategjik. Për këtë ministria përgjegjëse dhe institucionet raportuese duhet të marrin masa organizative për t'iu përshtatur në kohë dhe me cilësi procesit të raportimit dhe përpilimit të raporteve të monitorimit.

Ministria përgjegjëse për monitorimin kryen një sërë detyrash organizative, koordinuese më qëllim mbledhjen e të dhënave nga institucionet përgjegjëse, përpunimin e tyre, përpilimin e raporteve të monitorimit, konsultimin me palët e interesuara, si dhe marrjen e masave për adresimin e problematikave të hasura gjatë zbatimit, që rezultojnë sipas analizës së monitorimit.

Raportet e monitorimit nuk duhet të jenë të gjatë. Ato duhet të jenë të kuptueshëm nga publiku i gjerë dhe mundësisht të paraqesin të dhëna në format vizual (grafikë, tabela, skema).

Është e rëndësishme që raportet, jo vetëm të japin të dhëna dhe shifra, por edhe të analizojnë rezultatet e monitorimit, me qëllim që lexuesi të kuptojë jo vetëm ecurinë e zbatimit, por dhe problematikave të hasura dhe shkaqet e tyre.

Mbi bazën e tyre dhe vetë institucioni duhet të marrë masa për ndryshimin e planit të veprimit, me qëllim arritjen e objektivave.

MONITORIMI I JASHTËM

- Aktorët e përfshirë dhe rëndësia

Pavarësisht monitorimit nga institucioni përgjegjës, një monitorim realist dhe i pavarur mund të bëhet edhe nga të tretët, si: organizata të shoqërisë civile, ekspertë të pavarur apo akademia. Një monitorim i tillë mund të bëhet për të vlerësuar punën e institucioneve monitoruese, por edhe për të verifikuar dhe nxjerrë të dhëna më të detajuara, për aspekte me rëndësi në punën e tyre: si për shembull matja e progresit lidhur me aspekte të caktuara të një sektori, apo për të vlerësuar avancimin e sektorit, kundrejt detyrimeve momentale që i burojnë në kuadër të integritetit.

Në çdo rast, monitorimi i bërë nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile, siguron një transparencë, llogaridhënie dhe përfshirje më të madhe të qytetarëve dhe grupeve të interesit. Ai ofron një

monitorim objektiv, rezultatet e të cilit i shërbejnë qytetarit për të rritur besueshmërinë në procese, si dhe për të marrë të dhëna dhe rezultate të pavarura. Nga ana tjetër, mjetet e mbledhjes së të dhënave mund të përzgjidhen të tilla që të përfshijnë qytetarët në këto procese, si nëpërmjet anketave, sondazheve, konsultimeve, etj. Gjithashtu monitorimi dhe analizimi i rezultateve të bëra nga shoqëria civile, i shërben dhe institucioneve përgjegjëse në përmirësimin e punës së tyre, duke ndihmuar dhe kontribuar në zhvillimin e politikave dhe praktikave më efektive dhe të qëndrueshme.

- Organizimi i punës dhe hapat e monitorimit

1. Përcaktimi i qëllimit të monitorimit dhe organizimi i punës

Përpara fillimit të monitorimit është e rëndësishme të përcaktohet qartë qëllimi i monitorimit, pra arsyet se përse po ndërmerret një monitorim i jashtëm i dokumentit strategjik. Në varësi të interesit të përzgjedhur mund të vendoset të bëhet një monitorim i jashtëm i të gjithë strategjisë, apo mund të vendoset të vlerësohet progresi i një politike, apo disa objektivash specifike.

Monitorimi mund të bëhet për të marrë të dhëna të caktuara lidhur me një aspekt të sektorit, të mbuluar nga strategjia, për të marrë të dhëna për plotësimin e detyrimeve që burojnë nga integrimi evropian për sektorin, apo edhe për të vlerësuar saktësinë e procesit monitorues të bërë nga institucionet përgjegjëse.

E rëndësishme gjithashtu është të përcaktohen afatet brenda të cilave do të vlerësohet apo matet ecuria e progresit të zbatimit të objektivave të dokumentit strategjik. Psh. për 6 muajt e parë, apo për vitin e parë të dytë, të tretë, etj. të zbatimit të strategjisë.

Për një menaxhim efikas të punës dhe kohës, është e rekomandueshme që të ketë një organizim pune, duke përcaktuar përzgjedhjen e ekspertëve, ndarjen e detyrave, metodologjinë e mbledhjes së të dhënave, hartimin e një kalendarit të monitorimit që përfshin të gjitha veprimet dhe afatet për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për secilin tregues.

Këshilla praktike për OSHC

Hapi 1



Veprimi:

- Sigurohuni që organizata juaj ka kapacitetet e nevojshme dhe eksperiencën e duhur në fushën përkatëse.
- Formoni një grup ekspertësh të pavarur dhe objektivë brenda organizatës apo në një rrjet organizatash.

- Hartoni një plan pune të detajuar me ndarje detyrash dhe afate të qarta.
- Vendosni kontaktet me institucionin që ka hartuar politikën për të siguruar informacion të plotë, bazuar dhe në të drejtën për informim publik.
- Përdorni një metodologji të qartë për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave.
- Konsideroni asistencë dhe mbështetje nga ekspertë ndërkombëtarë nëse është e nevojshme.
- Bashkëpunoni me universitetet dhe lektorët, nëse do të keni nevojë për hartimin e metodologjisë apo përdorimin e metodave shkencore.

Qëllimi: Të sigurohet një proces monitorimi i strukturuar, objektiv dhe i fokusuar, që lejon matjen e progresit dhe identifikimin e sfidave.

Rezultati: Një plan i qartë i monitorimit, ekip ekspertësh objektiv dhe i pavarur, i pajisur me metodologjinë dhe kontaktet e nevojshme për të nisur analizën e strategjisë.

2. Identifikimi i treguesve kryesorë të matjes së performancës së politikave apo objektivave të përzgjedhur

Në vijim dhe në varësi të qëllimit pse vendoset të bëhet monitorimi, një proces i rëndësishëm është përzgjedhja e treguesve kryesorë të performancës për çdo objektiv specifik të strategjisë, të cilat do të përdoren në matjen e progresit dhe përmbushjen e rezultateve të pritshme.

Në varësi të qëllimit dhe interesit të monitoruesit, mund të përdoren të gjithë treguesit që i përkasin një objektiv, të vendosur dhe përzgjedhur nga dokumenti strategjik, apo disa prej tyre.

Gjithashtu, monitoruesit, në varësi të interesit të monitorimit, mund të identifikojnë vetë tregues shtesë, që masin progresin e objektivave apo masave të dokumentit, të cilët nuk janë të parashikuar në dokumentin strategjik.

Në këtë rast të fundit monitoruesi duhet të gjenerojë vetë metodologjinë e matjes dhe sistemin e referimit që ato përdorin për vlerësimin e progresit (formulën e matjes dhe vlerat bazë apo të synuara apo vlerat e marra në referencë në nivel krahasimor nga shtete të tjera).

Këshilla praktike për OSHC Hapi 2



Veprimi:

- Filloni duke rishikuar dokumentin strategjik dhe përzgjidhni objektivat që do të monitoroni.

- Identifikoni treguesit kryesorë të performancës për secilin objektiv; nëse nuk kuptohen mirë, kërkoni shembuj nga dokumente të ngjashme ose nga ekspertë të fushës.
- Për OSHC-të pa eksperiencë të konsoliduar, mund të përdoren tregues të thjeshtë dhe të qartë (p.sh., numri i politikave të zbatuara, përqindja e veprimeve të realizuara).
- Nëse është e nevojshme, shtoni tregues të rinj që nuk janë në dokumentin strategjik, duke menduar se si do të matni progresin.
- Për çdo tregues, përcaktoni mënyrën e matjes dhe referencat: vlera bazë, vlera e synuar, krahasim me praktikën e vendeve të tjera.

Qëllimi: Të krijohet një bazë e qartë dhe të matshme për vlerësimin e progresit të objektivave, që të lejojë çdo OSHC, pavarësisht përvojës, të kuptojë çfarë mund dhe duhet të monitorojë.

Rezultati: Krijimi i një liste treguesish të qartë për secilin objektiv, me metodologji të përcaktuar për matje dhe krahasim, që mund të përdoret për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave.

3. Identifikimi i të dhënave të nevojshme dhe burimeve të tyre

Pas përzgjedhjes së treguesve mbi bazën e të cilëve do të kryhet vlerësimi, duhet të identifikohen të dhënat apo informacionet që shërbejnë për matjen e tyre, sipas formulës së llogaritjes. Identifikimi i saktë i të dhënave apo informacionit është i rëndësishëm në mënyrë që të kemi aplikimin e rregullt të formulës së matjes dhe marrjen e një rezultati të saktë.

Njëkohësisht me evidentimin e të dhënave të nevojshme, bëhet identifikimi i institucioneve të ndryshme ku krijohen, mbahen apo përpunohen të dhënat. Burimi i të dhënave përveç institucioneve vendase apo dokumenteve të prodhuara prej tyre, mund të jenë edhe dokumentet e përpunuara nga organizatat ndërkombëtare, të cilat mbledhin dhe përpunojnë të dhëna për sektorë të ndryshëm. Burim mund të jenë grupet e interesit, ekspertë të fushës, qytetarët etj. Nëse informacioni posedohet nga disa burime, është e rekomandueshme që informacioni të merret nga 2 ose më shumë burime, edhe për të bërë një kontroll të kryqëzuar të tyre. Në varësi të të dhënave të nevojshme, identifikohen edhe mjetet e mbledhjes së të dhënave, të cilat mund të përfshijnë kërkesa për informacion pranë institucioneve, konsultim me faqe zyrtare në internet, apo dokumente publike, anketa, sondazhe, intervista, analizim dokumentesh, etj.

Pavarësisht burimit dhe mjetit të përdorur për të mbledhur të dhënat dhe informacionet e nevojshme për monitorim, është e rëndësishme që të mbahet në konsideratë, identifikimi i saktë i të dhënave dhe cilësia e tyre. Monitoruesi duhet të kujdeset që ato të jenë reale, të plota, të përditësuara dhe të besueshme. Në varësi të të dhënave, aty ku është e aplikueshme, rekomandohet organizimi i tyre në formate që lehtësojnë analizimin dhe vlerësimin, si p.sh. në tabela ose grafikë.

Këshilla praktike për OSHC Hapi 3



Veprimi:

- Përcaktoni të dhënat që ju nevojiten për çdo tregues matës. Shënoni burimet e mundshme: dokumente institucionale, faqet zyrtare, raportet e organizatave ndërkombëtare, intervista me ekspertë apo grupet e interesit.
- Sigurohuni që të dhënat të merren nga më shumë se një burim kur është e mundur, për të kryer kontroll të kryqëzuar dhe për të rritur besueshmërinë.
- Përdorni mjete të thjeshta për mbledhje të dhënash: kërkesa për informacion, konsultim të faqes zyrtare online, sondazhe me grupime vogla, intervista apo analiza dokumentesh.
- Organizoni të dhënat në mënyrë vizuale: tabela, grafikë ose formate që lehtësojnë analizën.

Qëllimi: Të sigurohet që të dhënat për secilin tregues janë të plota, të besueshme dhe të përditësuara, duke lehtësuar më tej analizimin e progresit të objektivave.

Rezultati: Një bazë të dhënash e qartë dhe e verifikuar, e strukturuar në mënyrë që OSHC-të, pavarësisht eksperiencës, të mund të kryejnë analizën e progresit dhe të raportojnë saktë gjetjet.

4. Analizimi i të dhënave të mbledhura dhe vlerësimi i ecurisë së zbatimit

Pasi sigurohen të dhënat, ekspertët bëjnë analizimin e tyre dhe hartimin e raportit të monitorimit. Analizimi i të dhënave të mbledhura bëhet, për secilin tregues matës, bazuar në metodologjinë dhe formulën e matjes, si dhe duke i krahasuar rezultatet e dala me vlerat bazë dhe vlerat e synuara të treguesit.

Rekomandohet që çdo rezultat të shoqërohet me një analizë të arsyetuar, e cila shpjegon progresin dhe punën e bërë për realizimin e tij, si dhe, sipas rastit, evidenton shkaqet apo pengesat që kanë ndikuar në mospërbushjen e rezultateve.

Pas analizimit të treguesve përkatës, analizohet dhe vlerësohet shkalla e progresit për çdo qëllim politike, objektiv strategjik, duke përfshirë njëkohësisht edhe ndikimin e rezultatit në progresin e bërë në përmbushjen e standardeve të BE-së apo përafrimin me Acquis.

Edhe në këtë rast evidentohen problemet e konstatuara gjatë zbatimit, si dhe shkaqet që kanë ndikuar në mosrealizimin në masën e synuar të objektivave apo qëllimeve të strategjisë.

Këshilla praktike për OSHC Hapi 4



Veprimi:

- Për secilin tregues, vendosni një tabelë krahasimi: vlera bazë – vlera aktuale – vlera e synuar
- Për çdo diferencë, shkruani shkaqet e mundshme (p.sh. mungesë burimesh, vonesa institucionale, problem metodologjik).
- Shënoni çdo arritje të veçantë që ka ndikuar pozitivisht në objektiv (p.sh. miratimi i një vendimi, publikimi i një raporti).
- Shkruani një paragraf të thjeshtë që shpjegon progresin e secilit objektiv: "Çfarë u arrit, çfarë jo, dhe pse".
- Kur është e mundur, përdorni grafikë ose diagrame për të ilustruar progresin.

Qëllimi: Të keni një pamje të qartë dhe të lexueshme të progresit dhe pengesave për çdo objektiv strategjik.

Rezultati:

- Raporti përfundimtar është i kuptueshëm edhe për ata që nuk kanë ekspertizë të thellë teknike.
- OSHC-të mund të identifikojnë fushat ku mund të japin rekomandime konkrete ose të kërkojnë informacion shtesë.
- Mundëson bashkëpunim më të drejtpërdrejtë me institucionet që zbatojnë strategjinë.

5. Hartimi i raportit të monitorimit dhe evidentimi i arritjeve apo mangësive

Pas analizimit dhe vlerësimit të të dhënave, hartohet raporti i monitorimit. Raporti i monitorimit duhet të ketë një strukturë të qartë, e cila jep informacion të plotë dhe të kuptueshëm për shoqërinë civile, qytetarët, si dhe institucionet publike. Një strukturë e mirë organizuar dhe një gjuhë e thjeshtë e raportit ndihmon në kuptimin e ecurisë së strategjisë nga publiku i gjerë, si dhe orienton administratën në marrjen e vendimeve të arsyetuara për rishikimin dhe përmirësimin e strategjisë.

Këshilla praktike për OSHC Hapi 5



Veprimi:

- Përdorni një strukturë të thjeshtë: hyrje – metodologjia – gjetjet kryesore – rekomandimet.
- Për secilën pjesë të strategjisë, shkruani çfarë u arrit, çfarë nuk u arrit, dhe pse (shkaqet e mundshme).

- Përdorni tabela ose diagrame për të ilustruar progresin dhe diferencat mes vlerave të synuara dhe atyre të arritura.
- Përcaktoni një seksion të veçantë për rekomandime konkrete që OSHC mund t'i dërgojë institucioneve përgjegjëse.
- Sigurohuni që raporti të jetë i lexueshëm për publikun e gjerë, jo vetëm për ekspertët.

Qëllimi: Të krijohet një dokument i qartë dhe i përdorshëm që tregon progresin dhe pengesat e zbatimit të strategjisë, dhe që mund të shërbejë si bazë për ndërveprime konstruktive me institucionet.

Rezultati:

- Raporti i përgatitur mund të përdoret për të argumentuar kërkesa për ndryshime ose përmirësime në strategji.
- Lejon OSHC-të të ndajnë gjetjet me qytetarët, media ose grupet e interesit.
- Rrit transparencën dhe mundësinë për të ushtruar ndikim real mbi politikën.

Format strukture mundshme për raportin e monitorimit të një strategjie sektoriale



1. Përmbledhja Ekzekutive.

Në këtë pjesë mund të përshkruhen:

- qëllimi dhe arsyeja e monitorimit të dokumentit strategjik, apo pjesëve të tij
- shkurtimisht përmbajtja e dokumentit strategjik, përfshirë qëllimet, objektivat dhe fushat kryesore ku orientohen masat dhe veprimet
- shkurtimisht rezultatet mbi progresin, sfidat dhe rekomandimet që dalin nga monitorimi.

2. Hyrje

Në këtë pjesë mund të jepet:

- përshkrimi i kontekstit dhe rëndësia e strategjisë që po monitorohet për sektorin apo sektorët që mbulon (p.sh., në lidhje me drejtësinë, korrupsionin, turizmin etj.).
- sqarimi i qëllimeve të monitorimit (p.sh., vlerësimi i realizimit të objektivave, progresi në kuadër të integritetit, ofrimi i asistencës për përmirësim, etj.).
- burimet dhe mjetet që janë përdorur për të mbledhur dhe analizuar të dhënat (p.sh., intervista, anketa, analiza të të dhënave statistikore).

3. Përshkrimi i dokumentit strategjik dhe Planit të Veprimit

Në këtë pjesë mund të përshkruhen:

- qëllimet e politikave dhe objektivave specifike të strategjisë.

- masat dhe aktivitetet që janë planifikuar që të realizohen për arritjen e këtyre objektivave
- rezultatet e synuara dhe burimet financiare të parashikuara për realizimin e strategjisë

4. Analizimi dhe vlerësimi i progresit të zbatimit

Kjo pjesë jep rezultatet e monitorimit, bazuar në matjen dhe vlerësimin e treguesve të performancës. Ajo duhet të përmbajë:

- përcaktimin e aktivitete të realizuara dhe ato në proces,
- ilustrimin e progresit nëpërmjet të dhënave që rezultojnë nga treguesit e matshëm
- analizën e arsyeve të progresit apo mospërmbushjes në realizimin e masave, duke evidentuar faktorët që kanë ndikuar (si buxheti në dispozicion, koha, kapacitetet institucionale, etj.)
- analizën dhe vlerësimin mbi shkallën e progresit të objektivave dhe qëllimeve të strategjisë dhe sesa janë përmbushur prioritetet e sektorit.

5. Evidentimi i problemeve dhe sfidave për të ardhmen

Kjo pjesë mund të përmbajë:

- problemet e evidentuara gjatë zbatimit
- pengesave që kanë ndikuar në mosrealizimin në masën e synuar të objektivave të strategjisë
- shkallën e përfshirjes së institucioneve përgjegjëse apo kontribuese, shoqërisë civile, grupeve të interesit apo qytetarët në procesin e zbatimit dhe monitorimit.

6. Rekomandime

Në këtë pjesë jepen sugjerime:

- për rishikimin e planit të veprimit, duke përfshirë rishikimin e masave apo aktiviteteve, rishpërndarjen e burimeve, ngritjen e kapaciteteve institucionale, etj.
- për zgjidhjen e problematikave, duke adresuar shkaqet e tyre
- për përmirësim në procesin e raportimit apo metodologjinë e monitorimit

7. Përfundime

- Kjo pjesë bën një përmbledhje të gjetjeve kryesore të monitorimit, duke përfshirë arritjet, problematikat, si dhe sugjerimet për përmirësim

6. Konsultimi i raportit të monitorimit

Është e rëndësishme që raporti i monitorimit të konsultohet me institucionet përgjegjëse, në mënyrë që të merret këndvështrimi i tyre mbi analizimin e strategjisë dhe gjetjeve që kanë rezultuar. Gjithashtu, raporti mund të konsultohet në forume me grupe të ndryshme të interesit që operojnë në sektorët e mbuluar nga strategjia, apo edhe me qytetarët, ku nëpërmjet takimeve, anketave apo sondazheve shihet sesi ata perceptojnë masat e ndërmarra në kuadër të strategjisë.

Këshilla praktike për OSHC Hapi 6



Veprimi:

- Organizoni takime të brendshme me ekipin tuaj për të diskutuar gjetjet e raportit dhe për të hartuar pyetje ose komente për institucionet përgjegjëse.
- Përdorni kanale të ndryshme për konsultim: kërkesa për informacion, platforma online për konsultim publik, takime publike, anketa ose sondazhe me qytetarët dhe grupet e interesit.
- Sigurohuni që çdo koment ose pyetje të jetë e qartë, e arsyetuar dhe e bazuar në të dhëna.
- Ndani gjetjet e konsultimit me grupet e interesit ose publikun për të rritur transparencën dhe përfshirjen.

Qëllimi: Përfshirja në procesin e konsultimit për të rritur transparencën dhe për të siguruar që gjetjet e monitorimit reflektojnë nevojat dhe perceptimet e komunitetit.

Rezultati:

- Marrja e reagimeve dhe qëndrimeve të drejtpërdrejta nga institucionet dhe komuniteti për progresin e strategjisë.
- Informimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për të rritur mbikëqyrjen dhe pjesëmarrjen publike.
- Formulimi i rekomandimeve të qarta dhe praktike për institucionet.

7. Publikimi i raportit të monitorimit

Raportet e monitorimit të hartuara nga shoqëria civile, duke qenë se janë raporte të pavarura, është e rekomandueshme që të jenë lehtësisht të aksesueshme për qytetarët, si dhe për çdo palë të interesuar mbi progresin dhe sfidat e implementimit të dokumentit strategjik.

Gjithashtu, për një kuptueshmëri më të madhe për publikun e gjerë, rekomandohet që pjesë të analizës, gjetjeve apo rekomandimeve të përpunohen duke mundësuar pasqyrimin vizual të të dhënave në infografikë, tabela, kolona, etj.

Këshilla praktike për OSHC Hapi 7



Veprimi:

- Sigurohuni që raporti i monitorimit të jetë i lehtë për t'u aksesuar: ngarkojeni atë në faqen tuaj zyrtare, dërgojeni tet rrjetet e OSHC-ve partnere, dhe shpërndajeni te grupet e interesit duke përdorur metoda të ndryshme të komunikimit dhe informimit
- Përpunoni gjetjet dhe rekomandimet në formate vizuale: tabela, kolona, grafikë ose infografikë për t'i bërë të qarta dhe të kuptueshme nga qytetarët dhe aktorët e tjerë.
- Komunikoni rezultatet përmes kanaleve online dhe takimeve publike për të rritur transparencën dhe ndërgjegjësimin e publikut.

Qëllimi: Raporti i monitorimit të jetë i aksesueshëm dhe i kuptueshëm për të gjithë aktorët, duke rritur ndikimin e punës monitoruese dhe vlerësuese të organizatave.

Rezultati:

- Qytetarët dhe grupet e interesit janë të informuar për progresin dhe sfidat e implementimit të strategjisë.
- Raporti përdoret si mjet për të ndërgjegjësuar institucionet dhe për të fuqizuar pjesëmarrjen qytetare.
- Rritet ndikimi i OSHC-ve në monitorimin e politikave publike.

8. Përfshirja në proceset e përmirësimit të dokumenteve strategjike

Shoqëria civile mund të përdorë rezultatet e monitorimit për të ndërgjegjësuar institucionet në marrjen e masave për përmirësimin e strategjive apo planeve të tyre të veprimit. Ajo gjithashtu, duhet të jetë e gatshme të bashkëpunojë dhe të ofrojë ekspertizën e saj në proceset e rishikimit dhe ndryshimit të strategjive apo planeve të veprimit.

Këshilla praktike për OSHC Hapi 8



Veprimi:

- Përdorni rezultatet e monitorimit për të identifikuar boshllëqet dhe mangësitë e strategjisë.
- Kontaktoni institucionet përgjegjëse për të ndarë gjetjet dhe rekomandimet konkrete.
- Ofroni ekspertizën tuaj gjatë rishikimit të strategjive dhe planeve të veprimit, duke propozuar përmirësime të bazuara në të dhëna dhe tregues objektivë.

- Bashkëpunoni me OSHC-të e tjera për të harmonizuar rekomandimet dhe për të forcuar zërin tuaj.

Qëllimi: Ndikimi aktiv në përmirësimin e dokumenteve strategjike dhe rritja e cilësisë së politikave publike.

Rezultati:

- Institucionet marrin input praktik dhe të bazuar në evidencë për rishikimin e strategjive.
- OSHC-të forcojnë rolin e tyre si aktorë të pavarur dhe të besueshëm në proceset e qeverisjes.
- Rritet ndikimi i monitorimit civil në përmirësimin e standardeve të politikave publike dhe përafrimin me kërkesat e BE-së.

Ky udhëzues synon t'i ndihmojë organizatat e shoqërisë civile të përfshihen në mënyrë më të qëndrueshme dhe me ndikim në proceset e monitorimit të politikave publike. Çdo hap, nga përcaktimi i qëllimit deri te përfshirja në përmirësimin e dokumenteve strategjike, i ofron OSHC-ve mjete praktike për të forcuar kapacitetet, për të ndërtuar partneritete efektive me institucionet dhe për të siguruar që zëri i tyre të reflektohet në politikat që prekin qytetarët. Duke ndjekur këto hapa, organizatat jo vetëm rrisin profesionalizmin e tyre, por edhe kontribuojnë realisht në përmirësimin e qeverisjes dhe transparencës publike në Shqipëri. Kontakto institucionet përgjegjëse për të ndarë gjetjet dhe sugjerimet e tua konkrete.